



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 10-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 25.01.2023, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
4. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
5. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
6. Enver Kryeziu, anëtar
7. Idajet Garip, anëtar
8. Zoran Cirkovic, anëtar

Të tjerë prezent

1. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
2. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
3. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 9 të Komitetit për Komunitete
2. Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023
3. Raporti mujor i punës së ZKK-së
4. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht me 8 vota aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 9-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstraktit nga mbledhja 9 -të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht votoi.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Plani i punës së Komitetit për Komitete për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi ,tha se e keni marr një draft të planin te punës së komitetit për komitete nga sektori i kuvendnit

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyq-Hasani, tha se është mirë qe informata nga Qendra për Punë Sociale të jetë në fillim të vitit. Kish qenë mirë qe të jetë në muajin Mars.

Gentianë Hoxhaj, edhe unë e kam një propozim qe informata nga Drejtoria Komunale e Arsimit të jetë në muajin Shtator.

Zoran Cikrovic, tha se po me pëlqejnë propozimet e parafolësve, por është mirë qe kur te kemi informata ja raporte nga drejtoratat e ndryshme nëse nuk vijnë drejtorët të paktën të e dërgojnë ndonjë zyrtar dhe te na informoj.

Shahadije Bikiliqi-Dragaçina, tha se unë e kam një propozim qe vizita të cilat ua bëjmë komiteteve mos të jetë në muajin tetor, por te kaloj ne muajt më herët për shembull në Korrik.

Zoran Cirkovic tha se e kam edhe një propozim qe ne si komitet të bëjmë një vizitë në Shqipëri, apo edhe në ndonjë komunën tjetër dhe do të shkëmbenim përvojat me njëri tjetrin.

Me qe diskutime tjera nuk pati, kryesuesi e hodhi ne votim planin e punës me propozimet qe cekura me lartë dhe p[as votimin u konstatua se komiteti me te gjitha votat për e votoi planin e punës së Komitetit për Komitete për vitin 2023

III

Raporti mujor i punës së ZKK-së

Lidhur me raportin mujor të punës së ZLK-së, ne pika të shkurta i njoftoi, Zoran Stanojevic

Pastaj Kryesuesi e hapsi diskutimin?

Zoran Cikrovic, tha se a janë nda te gjitha mjetet te cilat i keni pas ne dispozicion vitin e kaluar ju si ZLK?

Gentiana Hoxhaj, tha se edhe ne mbledhjen e kaluara kemi diskutuar dhe kemi thënë qe duhet të i dimë se sa raste janë ndihmuar saktë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se edhe unë pajtona me parafolësen qe te kemi informatë te saktë se sa persona janë ndihmuar nga komuniteti, serb, sa rom sa shkali, etj.

Shahadije Bikliqi, tha se a ndan mjete ministria për juve si ZLK?

Zoran Stanojevic, tha se ne si ZLK, i kemi pas 2 mijë euro ne dispozicion, dhe ato te gjitha janë nda për ata të cilët kanë bërë kërkesë të një hershme. Neve zyra e kryetarit na i ka shtuar edhe 1 mijë euro,ndërsa disa raste i ka ndihmuar direkt kryetari me ndihmë financiare. Jo nuk na ndan mjete asnjë ministri neve?

IV

Të ndryshme

Zoran Cirkovic,tha se kam një kërkesë nga anëtarët e komitetit të cilët janë edhe anëtarë të Kuvendit qe te bëhet kërkesë në Kuvend qe të rritet buxheti për ZLK-në.

Lumturije Bytyqi-Hasnai, tha se qe 14 vite qe jam unë ne asamble është i njëjti buxhet për ZLK-në.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14⁴⁵.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi